
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	---	--

Datë/a:	30.11.2018
Për/ Za/ To:	"AL-Group" SH.P.K
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AL-Group" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore", me Nr. të Prok: 616 18 77 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik "AL-Group" SH.P.K të dt. 16.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore", me Nr. 616-18-4828-512 dhe Nr. Brendshëm 616 18 77 512, kundër Vendimit të AK -së, të datës 13.11.2018.
2. Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: 13.11.2018 – sipas vendimit të OSHP-së 507-18.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i ndërtesave për mbrojtje të trashëgimisë kulturore", me Nr. Brendshëm 616 18 77 512 ta vazhdoj me vendimin për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës në bazë të obligimit të vendimit të OSHP-së 507-18.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.